

FONDI PËR KLIMËN E GJELBËR
PROJEKT PËR MBËSHTETJE PARAPËRGATITORE

Përmirësimi i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar sipas Marrëveshjes së Parisit

Vulnerabiliteti i grave ndaj ndryshimeve klimatike



MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT E SHQIPËRISË
INSTITUTI I KËRKIMEVE URBANE

Ky dokument është hartuar nëpërmjet Projektit për Mbështetje Parapërgatitore të Fondit për Klimën e Gjelbër për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë "Përmirësimi i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar" 2020-2022. Projekti është zbatuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane.

Instituti i Kërkimeve Urbane është Partner i Fondit për Klimën e Gjelbër në Zbatimin e Projekteve Parapërgatitore për Shqipërinë, nëpërmjet të cilave ai mbështet Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në zhvillimin e kuadrit strategjik kombëtar për ndryshimin e klimës si dhe të kapaciteteve njerëzore të nevojshme për zbatimin e tij.

Mendimet e shprehura në këtë dokument janë të Institutit të Kërkimeve Urbane. Instituti i Kërkimeve Urbane nuk mban përgjegjësi për mënyrën e përdorimit të përmbajtjes së dokumentit.

Hartuar nga:

Era Kraja, Instituti i Kërkimeve Urbane
Marinela Spahi, Instituti i Kërkimeve Urbane

Prill, 2022

© 2023 Instituti i Kërkimeve Urbane
Rruga "Asim Vokshi", Ndërtesa 14, Hyrja 11, Ap. 56
1057 Tiranë, Shqipëri
www.uri.org.al

Disa të drejta të rezervuara.

Ky punim është objekt i së drejtës së autorit. Meqenëse Instituti i Kërkimeve Urbane përkrah shpërndarjen e njohurive të tij, përmbajtja e punimit mund të riprodhohet, plotësisht ose pjesërisht, për qëllime jo tregtare, dhe duke dhënë referencë të plotë të autorit.

Punimi grafik: Jolin Matraku
Printuar: Express Print and Communication, Tiranë, Prill 2023



PARAFJALË

Ky dokument është një pasqyrë e dimensioneve të cënueshmërisë gjinore ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Ai mbështet Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në avancimin e procesit të integritit gjinor në politikën kombëtare të ndryshimeve klimatike, si pjesë e procesit të përmirësimit të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar për reduktimin e emetimeve të gazeve serë 2021-2030, si dhe për përmbushjen me cilësi të detyrimeve të Shqipërisë kundrejt Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Marrëveshjes së Parisit.

Instituti i Kërkimeve Urbane falënderon Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Drejtorinë e Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mbështetjen e tyre me të dhënat dhe informacionet e nevojshme për realizimin e kësaj analize, dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për koordinimin e komunikimit zyrtar ndërmjet institucioneve gjatë zbatimit të Projektit për Mbështetje Parapërgatitore "Përmirësimi i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar" 2020-2022.

Përmbajtja

1	HYRJE
1	ANALIZA GJINORE NË POLITIKAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
1	Kuadri ndërkombëtar
1	Kuadri kombëtar
1	Mbi ndryshimet klimatike
1	Mbi barazinë gjinore
3	Niveli i zbatimit të kuadrit kombëtar
4	UDHËZIME PËR INTEGRIMIN GJINOR NË POLITIKAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
4	Udhëzime ndërkombëtare: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
4	Udhëzime kombëtare: Komunikimi i Tretë Kombëtar
6	PROCESI I INTEGRIMIT GJINOR NË POLITIKAT KOMBËTARE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
6	Analiza e vulnerabilitetit të grave ndaj ndryshimeve klimatike
6	Dimensionet ndërkombëtare
7	Dimensionet kombëtare
10	Dimensionet në lidhje me eficiencën e energjisë
15	Treguesit dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë
15	Burimi i të dhënave
15	Burimet e treguesve
16	Treguesit e eficiencës së energjisë
16	Monitorimi dhe vlerësimi
16	PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE
17	NEVOJAT PËR RREGULLIM LIGJOR
17	NEVOJAT PËR KAPACITETE
19	PËRFUNDIME E REKOMANDIME

Figurat

- 11 Figura 1: Zinxhiri i ndikimit të ndryshimeve klimatike në vulnerabilitetin e grave, në familje
- 11 Figura 2: Zinxhiri i ndikimit të ndryshimeve klimatike në vulnerabilitetin e grave, sektori i bujqësisë
- 13 Figura 3: Zinxhiri i ndikimit të ndryshimeve klimatike në vulnerabilitetin e grave, sektori i energjisë
- 13 Figura 4: Dimensionet e vulnerabilitetit të grave ndaj ndryshimeve klimatike
- 18 Figura 5: Procesi institucional për integrimin e gjinisë në politikat e ndryshimeve klimatike

Shkurtime

COP	Conference of Parties (Konferencën e Palëve)
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
GES	Gaze me Efekt Serë
GNPNK	Grupi Ndërmintor i Punës për Ndryshimin e Klimës
INSTAT	Instituti i Statistikave
KKP	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar
KTK	Komunikimi i Tretë Kombëtar për Ndryshimin e Klimës
MRV	Matje, Raportim dhe Verifikim
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PKEK	Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën
SKNKPV	Strategjia Kombëtare për Ndryshimin e Klimës dhe Plani i Veprimit
SKPVBGJ	Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore
UNFCCC	United Nations Framework Convention on Climate Change [Konventa Kuadër mbi Ndryshimet Klimatike e OKB-së]
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. HYRJE

Ndryshimi i klimës është një çështje globale që ndërthuret me shumë problematika shoqërore, kulturore dhe ekonomike dhe nxjerr në dukje e përkeqëson vulnerabilitetin grupeve të ndryshme të njerëzve kudo në botë. Dimensionet e këtij vulnerabiliteti duhet të merren parasysh gjatë hartimit të politikave dhe masave për zbatimin e emetimit të gazeve me efekt serë dhe për përshtatjen ndaj ndikimit të tyre në klimë. Në rastin e grave, pabarazitë gjinore ekzistuese - të cilat burojnë nga rolet tradicionale gjinore dhe aksesit në burime - ndërthuren me ndikimet e ndryshimeve klimatike në një lidhje shkak-pasojë, duke përkeqësuar njëra-tjetrën. Ndërsa stinët ndryshojnë dhe ngjarjet e motit ekstrem dhe fatkeqësitë natyrore shpeshohen, është thelbësore që të shqyrtohet ndikimi i tyre mbi vulnerabilitetin e grave, dhe të trajtohet kjo çështje në nivelin e politikëbërjes.

Ky studim ofron një pasqyrë të dimensioneve të vulnerabilitetit të grave në Shqipëri ndaj ndryshimeve klimatike bazuar në analizat dhe të dhënat ekzistuese ndërkombëtare dhe kombëtare, me qëllim mbështetjen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë për Barazi Gjinore me rekomandime për të përparuar procesin e integritimit gjinor në politikat kombëtare të ndryshimeve klimatike.

2. ANALIZA GJINORE NË POLITIKAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

2.1. Kuadri ndërkombëtar

Konventa Kuadër mbi Ndryshimet Klimatike e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNFCCC), Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit, Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshja e Kopenhagenit janë marrëveshjet më të rëndësishme ndërkombëtare që i kushtojnë rëndësi shqyrtimit të ndryshimeve klimatike përmes një këndvështrimi gjinor. Vitet e fundit, komuniteti ndërkombëtar ka bërë përparim të mëtejshëm në integritimin e aspekteve gjinore dhe të të drejtave të njeriut në marrëveshjet për klimën. Programi i Punës për Gjininë i Limës u krijua në Konferencën e Palëve (COP20) në 2014 për të avancuar përfshirjen e aspekteve gjinore në punën e palëve mbi zbatimin e Konventës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të klimës. Në Marrëveshjen e Parisit, miratuar në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike të vitit 2015, përmendet rëndësia e përfshirjes së barazisë gjinore në veprimet klimatike

që në Preambul, si dhe advokohet zbatimi i masave që i përgjigjen problematikave gjinore. Gjithashtu, çështjet gjinore morën rëndësi të veçantë edhe në COP23, ku palët ranë dakord për krijimin e një Plani Veprimi për Gjininë, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha proceset e UNFCCC-së dhe mbështetjen për zbatimin e politikave klimatike që kanë ndjeshmëri gjinore.

Është e rëndësishme të theksohet se angazhimet gjinore të këtyre marrëveshjeve nuk janë detyrime ligjore; pra nënshkruesit vetëm inkurajohen të marrin në konsideratë dimensionin gjinor gjatë hartimit dhe zbatimit të politikave të tyre kombëtare për zbatimin dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

2.2. Kuadri kombëtar

2.2.1. Mbi ndryshimet klimatike

Ligji 155/2020 "Mbi ndryshimet klimatike" rregullon ndryshimet klimatike në Shqipëri dhe cakton Ministrinë për Mjedisin si institucionin më të lartë shtetëror përgjegjës për ndryshimet klimatike, pikën qendrore kombëtare për komunikimin pranë UNFCCC-së, dhe organin përgjegjës për koordinimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të matjes, raportimit dhe verifikimit të të dhënave, për procesin e përgatitjes së KKP-ve dhe Raporteve Përditësuese Dyvjeçare, si dhe për procesin e përgatitjes, zbatimit dhe raportimit mbi KKP-të. Ky ligj nuk detyron integritimin gjinor në politikat e ndryshimeve klimatike, duke reflektuar pra natyrën jo-detyruese të rekomandimeve të UNFCCC-së mbi analizën gjinore.

2.2.2. Mbi barazinë gjinore

Shqipëria ka ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme mbi barazinë gjinore, të tilla si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e vitit 1979 dhe Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje e vitit 2011, njohur ndryshe si Konventa e Stambollit.

Përpos zotimeve ndërkombëtare, barazia gjinore garantohet edhe në legjislacionin shqiptar. Ligji nr. 9970 "Mbi barazinë gjinore në shoqëri" rregullon themelet e barazisë gjinore, duke përfshirë mbrojtjen nga diskriminimi në arsimim, punësim dhe fusha të tjera të jetës publike, futjen e një kuote gjinore prej 30 për qind për pjesëmarrjen e grave në politikë-bërje dhe mbledhjen e detyrueshme të të dhënave të ndara sipas gjinisë nga të gjitha institucionet publike. Përveç kësaj, ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në vitin

2015 vendosën kuota edhe më të rrepta gjinore për listat e kandidatëve të zgjedhjeve të këshillit vendor, duke përcaktuar kuota të barabarta gjinie prej 50% si për burra edhe për gra. Dimensione të tjera gjinore janë përfshirë gjithashtu në Kodin e Punës, ligjin nr. 221 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", si dhe ligjin nr. 7703 "Për sigurinë shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Së fundi, ligji nr. 110/2018 "Për noterinë" ka shtuar një shtresë tjetër mbrojtjeje për pavarësinë financiare të grave, duke u garantuar atyre të drejtat pronësore.

Përpyekja e parë ligjore për integrimin e gjinisë në sistemin kombëtar të buxhetimit është bërë në vitin 2012, me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 465 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm". Në vitin 2016, u prezantuan ndryshime ligjore për ligjin nr. 9936 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Shqipëri," i ndryshuar, i cili e trajton barazinë gjinore si një nga parimet kryesore të planifikimit buxhetor vendor dhe kombëtar. Pas prezantimit të këtyre mekanizmave ligjorë, një raport i 2019 parashikoi një rritje të pjesës së buxhetit me ndjeshmëri gjinore në totalin e buxhetit nga 1 për qind në 6.3 për qind, si dhe një rritje të trefishtë të numrit të programeve buxhetore që kanë ndjeshmëri gjinore nga 2015 deri në 2021.¹ Nga ana tjetër, VKM nr. 592/2014 krijoi një fond në mbështetje të sipërmarrëseve gra, duke ndarë 26,5 milionë lekë për subvencionimin e normave të interesit të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të drejtuara nga gratë, për një periudhë katër vjeçare (2014-2017). Ndikimi i kësaj nisme financiare në përmirësimin e barazisë gjinore në vend duhet të analizohet më tej.

Duhet të theksohet se, siç ndodh shpesh edhe në vende të tjera, ndonëse gratë de jure janë të barabarta me burrat, zbatimi efektiv i legjislacionit mbetet i cungët dhe raportimi për barazinë gjinore është i pamjaftueshëm. Për të siguruar barazi de facto në të gjitha sferat e jetës duhet të bëhen më shumë përpjekje.

Ligji nr. 9970/2008 "Për barazinë gjinore"

Ligji nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri" rendit institucionet kombëtare përgjegjëse për përmirësimin e barazisë gjinore dhe përcakton Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ) si organin përgjegjës për integrimin gjinor në të gjitha fushat. KKBGJ është struktura më e lartë këshilluese që synon të integrojë gjininë në politikat dhe legjislacionin kombëtar. Ky organ kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale dhe përbëhet nga përfaqësues të qeverisë dhe anëtarë të organizatave të shoqërisë civile (OSHC).

Sipas ligjit, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT) dhe institucione të tjera kombëtare, mandatohet për krijimin e mekanizmave për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe për mbikëqyrjen e proceseve të grumbullimit dhe analizës së të dhënave. Përgjegjësia për mbledhjen, analizimin dhe ndarjen publike të informacionit është gjithashtu e ministrit, ndërsa institucionet publike në nivel vendor dhe kombëtar janë të detyruara të bashkëpunojnë me ministrin duke shkëmbyer informacione. Për më tepër, ligji përcakton institucionet e qeverisjes vendore si përgjegjëse për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Për këtë qëllim, kërkohet emërimi i të paktën një nëpunësi civil që merret me çështjet e barazisë gjinore në çdo bashki dhe i një nëpunësi civil gjinor në çdo ministri. Këta nëpunës civilë do të promovojnë barazinë gjinore në procedurat dhe legjislacionin e institucioneve të tyre përkatëse, për të siguruar integrimin gjinor ndërsektorial.

Udhëzimi nr. 1220/2010

Në udhëzimin nr. 1220/2010 "Për përcaktimin, mbledhjen, analizën dhe monitorim-vlerësimin e treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje" thuhet se çështjet që lidhen me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore (DHBGJ) mbulohen nga Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky organ ka për detyrë vlerësimin e informacionit statistikor dhe hartimin e raporteve mbi çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe DHBGJ, përfshi (i) mekanizmat ligjorë dhe institucionalë, (ii) fuqizimin e grave përmes pjesëmarrjes në vendimmarrje, (iii) fuqizimin ekonomik dhe mundësitë e punësimit të grave, (iv) promovimin e së drejtës për arsimim cilësor, (v) aksesin në shërbime sociale cilësore, dhe (vi) përmirësimin e përgjigjes së sistemit shëndetësor ndaj nevojave specifike të grave, etj.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2021-2030 (draft) thekson nevojën për të mbështetur dhe fuqizuar gratë dhe vajzat, duke përfshirë grupet më të cënuara që përballen me diskriminim të shumëfishtë, përkatësisht gratë që i

¹ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, 2019

përkasin pakicave etnike, të komunitetit LGBTI, gratë që jetojnë në zona rurale, gratë me aftësi të kufizuara, nënat e vetme, gratë e trafikuar, gratë e moshuara, etj, me shpresën e adresimit të nevojave të të gjitha grave në Shqipëri.

Nevoja për të ndryshuar ose shtuar dimensione për mirë-adresimin e pabarazisë gjinore komunikohet që në deklaratën e misionit të Strategjisë. Në mënyrë të veçantë, duhet të merren parasysh emergjencat civile, fatkeqësitë natyrore dhe çështje të tjera të ndërlidhura me gjininë, të tilla si ndryshimet klimatike dhe ekonomia e gjelbër. Së fundi, Strategjia gjithashtu identifikon lidhje me disa Objektiva të Zhvillimit të Qendrushëm të OKB-së, përfshirë Objektivin 13 mbi "Veprimin për Klimën".

Baza ligjore për qeverisjen vendore

Orvatje për të rritur barazinë gjinore janë bërë edhe në nivel vendor. Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i detyron kryetarët e bashkive të kenë parasysh balancën gjinore gjatë emërimit të nënkryetarëve dhe administratorëve të njëjësive administrative. Ky ndryshim ligjor, bashkë me ndryshimet e lartpërmendura në Kodin Zgjedhor, solli ndryshime pozitive për gratë, pasi përfaqësimi i tyre në pozicione vendimmarrëse në bashki dhe këshilla bashkiake u rrit pas zgjedhjeve të 2015-ës.

Përveç sa më sipër, ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ka krijuar një bazë për përfshirjen efektive të buxhetit me ndjeshmëri gjinore në të gjitha fazat e procesit të menaxhimit financiar vendor, me qëllim sigurimin e barazisë gjinore në planifikimin dhe shpenzimin e burimeve financiare publike. Ligji parashikon gjithashtu se kryebashkiakët kanë detyrimin të mbledhin, analizojnë dhe ndajnë publikisht të dhënat vendore të ndara sipas gjinisë.

2.2.3 Niveli i zbatimit të kuadrit kombëtar

Megjithëse Shqipëria është nënshkruese e këtyre marrëveshjeve, në ligjet, politikat apo strategjitë më të fundit kombëtare mbi ndryshimet klimatike, çështjeve gjinore nuk u është kushtuar rëndësi. Kontributi i parë Kombëtar i Përcaktuar, i dorëzuar në vitin 2015, nuk përmban analiza gjinore; Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit 2019-2030 nuk përmbajnë një analizë gjinore ose politika klimatike me ndjeshmëri gjinore; ligji nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike" nuk merr në konsideratë politikat gjinore në lidhje me ndryshimet klimatike. Politikat klimatike me ndjeshmëri gjinore nuk janë

përfshirë as në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2020, as në Strategjinë Kombëtare për Energjinë 2018-2030 dhe as në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2021-2030.

Në KKP-në e Rishikuar 2021-2030 përdoret gjuha e problematikave gjinore dhe i jepet përparësi promovimit të masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike sipas gjinisë. Megjithatë, paqartësia që karakterizon shumë pjesë të raportit – ndoshta për shkak të pamjaftueshmërisë së të dhënave gjinore dhe klimatike vendore dhe kombëtare – minimizon rëndësinë e tyre. Dokumenti zbulon qartë nevojën urgjente për një sistem matjeje, raportimi dhe verifikimi (MRV) mbi ndryshimet klimatike, siç kërkohet nga UNFCCC-ja, si edhe për një bazë ligjore për metodologjinë e integritit gjinor në politikat e zbatjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Përpjekje për të rritur barazinë gjinore janë bërë edhe në nivel vendor. Përveç bazës ligjore të diskutuar më sipër, shtatë bashki, përkatësisht bashkitë Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Shkodër, Tiranë dhe Durrës, kanë përforcuar angazhimet e tyre për arritjen e barazisë gjinore duke u bërë nënshkruese të Kartës Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Pesë nga këto komuna kanë marrë hapa konkrete për përgatitjen dhe miratimin e Planeve Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore, me synim nxitjen e mekanizmave të qeverisjes vendore për arritjen e barazisë gjinore. Që atëherë, të tjera bashki, përkatësisht bashkitë Kamëz, Dibër, Gramsh, Bulqizë, Cërrik dhe Pogradec i janë bashkuar listës së nënshkruesve të Kartës, por pak prej tyre kanë marrë masa konkrete për hartimin e planeve të veprimit dhe zbatimin e tyre.

3. UDHËZIME PËR INTEGRIMIN GJINOR NË POLITIKAT E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Udhëzime ndërkombëtare: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Udhëzuesi i UNDP-së "Barazia Gjinore në Veprimin Kombëtar të Klimës: Planifikimi për integrimin gjinor në KKP", ofron një sërë pikash hyrëse kyçe për zhvillimin e veprimeve për ndryshimet klimatike me ndjeshmëri gjinore.

A. Analiza e vulnerabilitetit të grave

Si fillim, për të kuptuar plotësisht sfidat e pabarabarta gjinore të burrave dhe grave në vend, nevojitet një analizë e plotë e kontekstit kombëtar me të dhëna të ndara sipas gjinisë; nga ana tjetër, duhet të bëhet edhe një analizë e faktorëve socio-ekonomikë, përfshirë dinamikat gjinore, arsimimin dhe varfërinë, për të identifikuar kriteret e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Kjo përmbledhje duhet të përfshijë një vlerësim të rreziqeve klimatike, dimensioneve socio-kulturore, si dhe statusit ekonomik të sektorëve të cënuar nga ndryshimet klimatike, si bujqësia, energjia dhe turizmi. Këto analiza mund të shërbejnë më pas për të ndërtuar bazën e referimit dhe identifikuar treguesit gjinorë. Udhëzuesi sugjeron përfshirjen e organizatave të grave si partnere të rëndësishme në procesin e identifikimit të problematikave.

B. Vlerësimi i kuadrit institucional dhe bashkëpunimit ndër-institucional

Analizat e vulnerabilitetit duhet të ndiqen nga një vlerësim i kuadrit institucional dhe një vlerësim i bashkëpunimit ndërministror dhe ndër-sektorial mbi barazinë gjinore. Udhëzuesi propozon vlerësimin e (i) integritit të mekanizmave gjinorë në institucionet qeveritare që merren me çështjet e ndryshimeve klimatike dhe (ii) përfshirjes së buxhetimit gjinor në mekanizmat e politikave klimatike. Përveç kësaj, duhet gjithashtu të mbështetet roli drejtues i grave në koordinimin e veprimeve për ndryshimet klimatike duke siguruar përfaqësimin e drejtë dhe të barabartë të tyre në proceset e planifikimit dhe zbatimit.

C. Integrimi gjinor në politikat e ndryshimeve klimatike dhe instrumentet e planifikimit

Më tej, udhëzuesi sugjeron integrimin e dimensioneve gjinore në instrumentet e ndryshimeve klimatike, përfshi ato ndërkombëtare, si Veprimi Zbutës i Përshtatshëm për Vendin (NAMA), Planet Kombëtare të Përshtatjes (NAP), dhe mjete të tjera të politikave dhe planifikimit kombëtar. Gjatë zhvillimit të politikave të reja për ndryshimet klimatike, duhet të merren parasysh gjithashtu edhe angazhimet kombëtare ekzistuese për barazinë gjinore, përkatësisht ligji

"Për Barazinë Gjinore" dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030.

D. Konsultimet me palët e interesuara

Raporti thekson nevojën për të rritur angazhimin e grave në konsultimet shumë-palëshe me aktorë të interesit, në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, si dhe për të mundësuar përfaqësimin e pikëpamjeve të të gjitha palëve të interesuara. Për këtë qëllim, aktorët joqeveritarë, përfshi shoqërinë civile dhe sektorin privat, duhet të përfshihen në proceset e analizës, përcaktimit të kontekstit, identifikimit të partnerëve dhe planifikimit të masave dhe veprimeve. Organizatat e grave, si edhe shoqëria civile dhe organizatat komunitare luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm në përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve.

E. Zhvillimi i kapaciteteve

Për zhvillimin e kapaciteteve, duhet të promovohen dhe ruhen përpjekjet e komuniteteve të ndryshme, organizatave të grave dhe zyrtarëve qeveritarë, në mënyrë që të forcohet kohezioni i politikave mbi veprimet për zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike. Udhëzimi sugjeron që stafi qeveritar i angazhuar në sektorin e ndryshimeve klimatike të trajnohet mbi hartimin e projekteve gjinore, treguesit dhe analizat gjinore, në mënyrë që të kuptojë rëndësinë e përfshirjes së dimensioneve gjinore në strategjitë dhe planet e institucioneve të tyre përkatëse, si edhe të lehtësojë procesin e integritit gjinor në politikat klimatike. Në nivel komunitar, ngritja e kapaciteteve mund të bëhet si formalisht, d.m.th. duke ofruar mundësi për arsim të lartë në energji, bujqësi dhe sektorë të tjerë të lidhur me klimën, edhe joformalisht, me anë të fushatave informuese.

F. Monitorimi dhe vlerësimi

Si pjesë e procesit të matjes, raportimit dhe verifikimit, puna dhe rezultatet duhet të monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht gjatë gjithë procesit të zhvillimit, duke iu referuar treguesve gjinorë dhe të dhënave të ndara sipas gjinisë.

G. Financa

Së fundi, udhëzuesi nënvizon rëndësinë e integritit gjinor në mekanizmat e financimit të klimës, përmes fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare të klimës dhe mjeteve të financimit të klimës që targetojnë gratë sipërmarrëse dhe projektet e sipërmarrjet që kanë në fokus gratë.

Në Komunikimin e Tretë Kombëtar të Republikës së Shqipërisë mbi Ndryshimet Klimatike, renditen katër elemente si kontribuese të një mjedisi mundësues dhe të favorshëm për integrimin gjinor në politikat e ndryshimeve klimatike, përkatësisht, (i) kuadri ligjor, (ii) politikat, (iii) institucionet qeveritare dhe (iv) financat. Këto elemente konsiderohen si parakushte për integrimin gjinor në politikat klimatike. KTK-ja rendit gjithashtu tre hapa që duhet të merren parasysh në mënyrë që integrimi gjinor në programet ose planet e ndryshimeve klimatike të jetë i suksesshëm, përkatësisht (i) angazhimi i palëve të interesuara, (ii) mbledhja e informacionit dhe (iii) monitorimi.

1. Parakushtet për integrimin gjinor në politikat e klimës

1.1. Kuadri ligjor

Kuadri ligjor duhet të sigurojë patjetër barazi gjinore dhe të adresojë diskriminimin gjinor, ndërsa një kuadër ligjor më i zhvilluar duhet të kërkojë gjithashtu integrimin gjinor në dokumentet ligjore që rregullojnë zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike. Gjithashtu, duhet të bëhet një vlerësim i plotë i nivelit të zbatimit të legjislationit në nivel kombëtar dhe vendor. Kjo do të përfshinte një vlerësim të qasjes në drejtësi dhe të procedurave administrative.

1.2. Politikat

Politikat e suksesshme dhe efektive janë një tjetër element i rëndësishëm i një mjedisi mundësues dhe të favorshëm. Politikat gjinore konsiderohen si tregues të ndërgjegjësimit gjinor në rang kombëtar dhe si parametra të mënyrës si duhet të trajtohen problematikat gjinore në rang vendor. Për të qenë efektive, politikat duhet të ndërtohen mbi mbledhjen metodike të të dhënave të ndara sipas gjinisë nga sektorë të ndryshëm, ndërsa procesi i politikëbërjes, veçanërisht ai i politikës mjedisore, politikave energjetike, politikave industriale, etj. duhet të marrë parasysh dimensionet gjinore.

1.3. Institucionet qeveritare

Zbatimi i suksesshëm i ligjeve dhe politikave varet, për më tepër, nga ndërgjegjësimi i mirëfilltë i zyrtarëve qeveritarë për çështjet gjinore. Meqenëse ato kanë rol kyç në integrimin e përshtatshëm gjinor në nivel kombëtar dhe vendor, ministritë dhe organet e tjera qeveritare duhet të kuptojnë mirë dimensionet gjinore. Kjo mund të arrihet duke rritur përfaqësimin e grave në ministritë e linjës dhe institucionet përkatëse, si edhe duke i ofruar stafit të tyre trajnim të mjaftueshëm mbi çështjet gjinore.

1.4. Financat

Së fundi, integrimi i suksesshëm i gjinisë nuk mund të realizohet pa politikat e duhura buxhetore. Financat publike, veçanërisht financat për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurojnë dhe të mbështesin barazinë gjinore. Një mjedis mundësues dhe i favorshëm siguron zbatim të duhur dhe efektiv, që përfshin edhe sigurimin e mjeteve të mjaftueshme financiare për aktivitete me ndjeshmëri gjinore.

2. Hapat që duhen marrë parasysh për integrimin gjinor në programet ose planet e ndryshimeve klimatike

2.1. Palët e interesuara

Sa i përket palëve të interesuara, është me rëndësi që ekipi i zhvillimit të politikave (i) të pasqyrojë balancë gjinore, (ii) të jetë shumë i ndërgjegjësuar për çështjet gjinore, (iii) të përfshijë ekspertizë të jashtme nga ekspertë të çështjeve gjinore dhe (iv) të ndërtojë kapacitetet e veta gjinore. Procesi i angazhimit të palëve të interesuara duhet të vazhdojë edhe përtej fazës fillestare të planifikimit. Qëllimi është inkurajimi dhe mbështetja e partneriteteve afatgjata midis të gjitha palëve dhe stimulimi i bashkëpunimit mes sektorëve dhe sferave politike.

2.2. Mbledhja e të dhënave

Ky hap konsiston në mbledhjen dhe dokumentimin e informacionit në lidhje me programin klimatik të planifikuar. Analiza gjinore është e domosdoshme për zhvillimin e politikave për ndryshimet klimatike, prandaj edhe mbledhja e të dhënave duhet të integrojë gjininë. Disponueshmëria dhe besueshmëria e të dhënave është thelbësore në këtë pjesë të procesit, prandaj është thelbësore që të intensifikohen përpjekjet për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë, ndarjen e tyre me institucionet përkatëse dhe disponueshmërinë e tyre publike.

2.3. Monitorimi dhe vlerësimi

Së fundi, progresi në zbatimin e angazhimeve për integrimin gjinor duhet të monitorohet. Treguesit gjinorë duhet të përdoren për të gjurmuar ndryshimet gjatë dhe pas periudhës së zbatimit të programit. Pjesëmarrja e grave në procesin e monitorimit duhet të inkurajohet.

4. PROCESI I INTEGRIMIT GJINOR NË POLITIKAT KOMBËTARE TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Bazuar në udhëzimet e UNDP-së dhe KTK-së, seksioni më poshtë përshkruan procesin e integrimit gjinor në politikat kombëtare të ndryshimeve klimatike sipas legjislationit në fuqi.

4.1. Analiza e vulnerabilitetit të grave ndaj ndryshimeve klimatike

4.1.1. Dimensionet ndërkombëtare

Ndryshimet klimatike ndërthuren me disa problematika shoqërore, kulturore dhe ekonomike. Ndikimi i ndryshimeve ndërvepron me gjininë, racën, etnicitetin, gjendjen socio-ekonomike dhe elemente të tjera të shoqërisë njerëzore, duke kontribuar në pabarazi shoqërore dhe padrejtësi sistematike. Studimet tregojnë se ndikimi i ndryshimeve të ashpra klimatike mbi burrat dhe gratë përcaktohet nga një sërë dimensionesh vulnerabiliteti.

Rolet gjinore tradicionale krijojnë pabarazi të konsiderueshme në mënyrën se si gratë dhe burrat ndikohen dhe përshtaten me klimën në ndryshim, dhe gratë në mbarë botën ekspozohen ndaj rreziqeve më të mëdha se partnerët e tyre meshkuj. Rolet gjinore konsistojnë në detyra të ndryshme shoqërore midis burrave dhe grave, ku, tradicionalisht, gratë bartin barrën më të madhe të kujdesit për fëmijët e të moshuarit dhe të mirëmbajtjes së shtëpisë, përfshirë gatimin, mbushjen e ujit ose sigurimin e lëndëve djegëse për ngrohje dhe gatim etj. Mesatarisht, gratë në të gjithë botën, shpenzojnë tre herë më shumë kohë për punë shtëpie dhe përkujdesje të papaguar (për fëmijët, të moshuarit, etj.) se burrat². Këto role kufizojnë aftësinë e grave për t'u arsimuar, për të arritur pavarësi ekonomike dhe për të shijuar aktivitete në kohë të lirë. Në zonat rurale kjo barrë është edhe më e madhe se në zonat urbane.

Qasja ligjore në burime gjithashtu krijon pabarazi të konsiderueshme në mënyrën se si gratë dhe burrat ndikohen dhe përshtaten me ndryshimet klimatike. Për shkak të normave kulturore dhe të drejtave ligjore të kufizuara, gratë në mbarë botën përballen me barriera më të larta se burrat sa i takon aksesit në burime të ndryshme, si toka, teknologjia dhe forma të tjera të kapitalit, si dhe në arsim dhe trajnime. Kjo limiton kapacitetet e tyre për t'u përshtatur ndaj ndikimit të ndryshimeve klimatike.

Ndryshimet klimatike sjellin një sërë pasojash negative, si rritje të temperaturave, ngjarje ekstreme të motit dhe katastrofa natyrore, etj. Në vendet e prekura nga fatkeqësitë natyrore është vënë re se varfërimi i përhapur i shkaktuar nga fatkeqësitë rriti rrezikun e ekspozimit ndaj dhunës me bazë gjinore dhe se shkalla e dhunës seksuale dhe DHBGJ-së u rrit gjatë fatkeqësive të zgjatura, si thatësitat dhe fatkeqësitë natyrore³.

Gjithashtu, këto ndryshime kanë një ndikim veçanërisht të madh në sektorin e bujqësisë, duke qenë se përmytjet, thatësitat, erozioni, rrëshqitjet e dheut, etj. mund të ulin prodhimin pyjor dhe bujqësor, duke shkaktuar pasiguri ushqimore në mbarë botën. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në sektorin e bujqësisë janë veçanërisht të rënda për gratë, të cilave do t'u rritet ngarkesa e punës dhe do t'u duhet të ecin distanca më të gjata për të siguruar ujë dhe lëndë djegëse, etj.

Për më tepër, impakti i ndryshimeve klimatike mund të jetë më i rëndë për gratë edhe për shkak të barrierave me të cilat ato përballen për akses në burimet, përfshi mungesën e pronësisë mbi tokën ose të drejta të kufizuara të pronësisë, mungesën e informacionit dhe qasjen e limituar ndaj teknologjisë dhe novacioneve. Si rrjedhojë e mungesës së aseteve fizike dhe kolateralit, grave u cënohet aftësia për të aksesuar shërbimet financiare formale, për të marrë hua dhe për të investuar në mjete dhe praktika të avancuara bujqësore që të mund të mbrohen nga ndikimi i ndryshimeve klimatike. Për më tepër, trajnimet për bujqësinë e qëndrueshme në përgjithësi nuk targetojnë gratë, ndaj grave u mungon ekspertiza teknike mbi praktikatat moderne të zbutjes dhe përshtatjes me ndryshimet klimatike.

Këto sfida jo vetëm që pengojnë aftësinë e grave për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike dhe për t'u rimëkëmbur shpejt nga fatkeqësitë, por edhe kufizojnë më tej mundësitë e tyre, duke ulur nivelin e arsimimit, rritur rrezikun e varësisë ekonomike, pasigurisë ushqimore ose varfërisë, dhe në të njëjtën kohë, duke i lënë ato më të pambrojtura ndaj dhunës në familje dhe asaj seksuale. Në këtë mënyrë, cikli i vulnerabilitetit vazhdon të thellohet, veçanërisht për gratë që jetojnë në zonat rurale, dhe ato që punojnë në bujqësi.

Është e rëndësishme të theksohet se edhe mes grave, ka shtresa të shumta vulnerabiliteti ndaj ndryshimeve klimatike. Një studim⁴ që shqyrtoi ndikimin e katastrofave klimatike në hendekun

2 United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women, 2019

3 Federation of Red Cross & Red Crescent Societies, 2015

4 Neumayer, E. dhe Plümpert, T., 2007

gjinnor të jetëgjatësisë përgjatë 20 vjetësh, konkludoi në dy gjetje kryesore. Së pari, të dhënat treguan se mesatarisht vriten më shumë gra se burra nga fatkeqësitë natyrore dhe efektet që pasojnë. Së dyti, autorët e studimit zbuluan se edhe statusi socio-ekonomik është po aq i rëndësishëm në përcaktimin e shkallës së vdekshmërisë nga fatkeqësitë, që do të thotë se sa më i ulët të jetë statusi socio-ekonomik i grave, aq më i fortë është efekti në hendekun gjinnor të jetëgjatësisë.

Spektori i energjisë është gjithashtu me rëndësi të veçantë për sa i përket vulnerabilitetit shpërpjesëtimor të grave ndaj ndryshimeve klimatike. Varfëria energjetike, që manifestohet si mungesë e energjisë elektrike ose si papërballueshmëri ekonomike dhe pamjaftueshmëri e shërbimeve energjetike në shtëpi, është problem jetik për shumë njerëz anembanë botës. Ndikimet e ndryshimeve klimatike, përfshirë shpeshimin dhe përforcimin e ngjarjeve ekstreme të motit dhe fatkeqësive natyrore, sidomos të thatësirave, përforcojnë varfërinë energjetike. Me akses të reduktuar në energji elektrike, gratë, të cilat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e familjes si pasojë e roleve tradicionale, duhet të përdorin biomasë, qymyr dhe vajguri për gatim e ngrohje. Këto lëndë djegëse shkaktojnë ndotje të ajrit brenda shtëpisë, duke dëmtuar veçanërisht shëndetin e fëmijëve dhe grave, duke qenë se ato shpenzojnë më shumë kohë në shtëpi dhe gatuajnë shumicën e vakteve, sërish për shkak të roleve tradicionale gjinore. Në fakt, studimet tregojnë se nga 2.5 milionë vdekjet vjetore që i atribuohen mungesës së aksesit në gatim me energji të pastër⁵, 85 për qind mendohet të jenë gra dhe fëmijë që vdesin nga sëmundjet e frymëmarrjes dhe kanceri⁶. Përveç kësaj, sigurimi i lëndëve djegëse është gjithashtu një barrë që bie mbi gratë, që u lë atyre pak kohë për t'u arsimuar, për të punuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje në komunitetet e tyre. Pabarazitë gjinore në sektorin e energjisë manifestohen edhe në fuqinë punëtore; sektori vazhdon të ketë diversitet gjinnor shumë të ulët, me vetëm 22 për qind gra të punësuar në sektorin e energjisë në përgjithësi, dhe 32 për qind në sektorin e energjisë së rinovueshme⁷.

Si përfundim, rolet tradicionale gjinore dhe aksesit i ulët i grave në burime janë shkaqet kryesore ose nxitësit e vulnerabilitetit shpërpjesëtimor të grave ndaj ndryshimeve klimatike në krahasim me burrat. Pabarazia gjinore dhe padrejtësia sistematike ekzistuese në shoqërinë njerëzore intensifikojnë ndikimet e ndryshimeve klimatike tek gratë në

krahasim me burrat, dhe për rrjedhojë përkeqësojnë pabarazinë dhe padrejtësinë ekzistuese. Kjo marrëdhënie është e pranishme si në familje ashtu edhe në sektorët bujqësorë dhe energjistikë, dhe është më e përhapur në zonat rurale se në ato urbane.

4.1.2. Dimensionet kombëtare

Në rang kombëtar, disponueshmëria e të dhënave është e kufizuar, dhe ndikimi i ndryshimeve klimatike tek gratë ose në ndonjë grup vulnerabel në përgjithësi është shqyrtuar nga shumë pak studime. Të dhënat dhe studimet që ekzistojnë nënvizojnë ndërthurjen mes problematikave të pabarazisë gjinore dhe atyre të ndryshimeve klimatike dhe, në përputhje me atë që u diskutua më lart, tregojnë se fatkeqësitë klimatike reflektojnë dhe përforcojnë pabarazitë gjinore.

Një publikim i fundit i INSTAT-it⁸ hodhi dritë mbi pabarazitë gjinore që ekzistojnë në Shqipëri në disa fusha. Lidhur me aksesin e grave në burime të ndryshme, të dhënat e INSTAT-it zbuluan një disproporcion të dukshëm në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore që rrjedh nga rolet gjinore; përkatësisht 18.8 për qind e grave, krahasuar me vetëm 0.6 për qind të burrave, treguan se arsyeja kryesore pse kanë mbetur jashtë fuqisë punëtore është përgjegjësia e tyre për kujdesin e familjes. Përveç kësaj, publikimi zbuloi se më shumë gra sesa burra bëjnë punë informale ose me pagë të ulët. Nga ana tjetër, për sa i përket papunësisë, nuk ka dallime të theksuara gjinore, pasi përqindjet e grave dhe burrave të papunë në Shqipëri në vitin 2020 ishin përkatësisht 12.4 për qind dhe 12 për qind. Paragjykimi gjinnor i ngulitur dhe dinamikat gjinore detyrojnë gratë të bartin një barrë shpërpjesëtimore në familje, që i shkurajon ato nga pjesëmarrja në fuqinë punëtore, ua kufizon mjetet e jetesës dhe i bën ato më të ndjeshme ndaj ndikimeve negative të një klime në ndryshim, përfshirë marginalizimin ekonomik dhe politik, varfërinë energjetike dhe problemet shëndetësore.

Statistikat mbi mbajtësit e llogarive bankare në Shqipëri pasqyrojnë gjithashtu mjaft qartë edhe brishtësinë e gjendjes ekonomike të grave. Vetëm 43.5 për qind e llogarive depozituese në bankat tregtare shqiptare i përkasin grave⁹, që do të thotë se ato kanë më pak mundësi për të mbrojtur kursimet e tyre, duke çenuar më tej aftësitë e tyre për t'u përgatitur dhe për t'u përgjigjur fatkeqësive natyrore që lidhen me klimën.

5 International Energy Agency, 2021

6 United Nations Industrial Development Organization & United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women, 2013

7 International Renewable Energy Agency, 2019

8 INSTAT, 2021b

9 INSTAT, 2021c

Mbi ndikimin shpërpjestimor të pasojave të ndryshimeve klimatike në jetën e grave rurale në Shqipëri, ka disa dëshmi. Një raport i UN Women¹⁰ për Shqipërinë hedh dritë mbi pasojat negative me të cilat u përballën gratë në vend pas përmbytjeve të vitit 2015, kur u dëmtuan 10,000 ha tokë bujqësore në Shqipërinë juglindore. Studimi konstatoi se, si pasojë e përmbytjeve, u rrit dhuna me bazë gjinore, si në familje edhe jashtë saj. Për më tepër, u vu re një rritje e konsiderueshme në ngarkesën mesatare të punës së grave, pjesërisht si rezultat i humbjes së aksesit në shërbimet e kujdesit dhe arsimit për fëmijët, të cilat normalisht lehtësojnë ngarkesën e grave. Së fundi, nga anketa u zbulua edhe një ulje e të ardhurave mesatare mujore të grave në zonat e prekura. Megjithatë nevojiten akoma më shumë kërkime, këto të dhëna ndihmojnë në ilustrimin e ndikimit të diferencuar nga gjinia e një klime në ndryshim, veçanërisht në kontekstin rural shqiptar.

Sipas publikimit të lartpërmendur të INSTAT-it, 414 për qind e grave të punësuara në Shqipëri punojnë në sektorin e bujqësisë, krahasuar me 31.8 për qind të meshkujve¹¹. Megjithatë krahu i punës në ferma dominohet nga gratë, vetëm 7.8 për qind e pronarëve të fermave janë gra, nga të cilat 65.9 për qind janë kryefamiljare, sipas të dhënave të INSTAT-it.¹² Bujqësia në Shqipëri është përgjithësisht në nivel mbijetese, dhe sipërfaqja mesatare e tokës së punueshme është tepër e vogël, rreth 1.2 hektarë, megjithatë, pronaret gra të fermave kanë akses më të ulët se pronarët burra në parcelat e punueshme me sipërfaqe më të madhe: respektivisht vetëm 0.5 për qind e grave dhe 1.2 për qind e burrave punojnë më shumë se 5 hektarë tokë bujqësore të shfrytëzuar. Me rritjen e temperaturave dhe ndryshimin e regjimit të reshjeve, ngjarjet ekstreme të të nxehtit, zjarret, erozioni, thatësitat dhe përmbytjet do të bëhen më të shpeshta, duke cënuar kështu mundësitë e popullsisë rurale për zhvillim dhe disponueshmërinë e ujit dhe sigurinë ushqimore për shumë komunitete. Duke marrë parasysh punësimin e gjerë të grave në bujqësi, nivelin e mbijetesës mbi të cilin zhvillohet aktiviteti bujqësor në vend, dhe për shkak të pronësisë më të kufizuar dhe aksesit të limituar të grave në sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore të shfrytëzueshme, gratë rurale në Shqipëri janë më të ekspozuara ndaj rrezikut të pasigurisë ushqimore dhe varfërisë se sa burrat.

Përpos bujqësisë, edhe sektori i energjisë çënohet nga ndryshimet klimatike. Paqëndrueshmëria e lartë e

regjimit të reshjeve, rritja e temperaturave dhe shtimi i ngjarjeve ekstreme të motit si pasojë e ndryshimeve klimatike mund të ndikojnë mbi furnizimin me energji, ndërsa kërkesa për energji vazhdon të rritet për rrjedhojë të rritjes ekonomike të vendit. Këto dinamika mund gjithashtu të çënojnë gratë më shumë se burrat. Me rreth 7 për qind, biomasa është burimi i tretë më i përdorur i energjisë në vend, veçanërisht në familje dhe në sektorin e shërbimeve. Duke qenë se gratë bartin barrën e punëve të shtëpisë, ato janë më të rrezikuara nga intensifikimi i varfërisë së energjisë. Në Kontributin Kombëtar të Përcaktuar, të paraqitur gjatë COP26, pohohet që, pavarësisht se sektori i energjisë lidhet përgjithësisht me burrat, gratë janë menaxheret e energjisë në familje.¹³ Kështu, nëse ndryshimet klimatike përkeqësojnë furnizimin me energji dhe varfërinë e energjisë në Shqipëri, gratë rrezikojnë të përballen me pasojat më të rënda se burrat për sa i përket shëndetit, arsimit, punësimit dhe pjesëmarrjes në vendimmarrje.

KKP 2021--2030 paraqet të dhëna gjinore shtesë mbi mënyrën se si ndryshimet klimatike ndikojnë shëndetin. Sipas raportit, gratë shqiptare kanë gjasa më të mëdha se burrat të kenë problematika shëndetësore pas fatkeqësive të lidhura me klimën. Në mënyrë të veçantë, gratë shtatzëna janë më vulnerabël ndaj rritjes së temperaturës dhe kufizimit të aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor pas katastrofave. Një studim tjetër zbuloi se përhapja e astmës është rritur mesatarisht 5 për qind çdo vit gjatë viteve të fundit dhe pritet të vazhdojë të rritet. 800-1200 rastet e astmës që shtohen çdo vit i atribuohen ndryshimeve klimatike dhe kryesisht kërcënojnë njerëzit që jetojnë në Vlorë ose rrethinat e saj dhe gratë.¹⁴ Gratë rurale gjithashtu mund të ndikohen në mënyrë shpërpjestimore, pasi biomasa mbetet burimi më i zakonshëm i energjisë në familjet rurale.¹⁵

10 Te Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2021a

11 INSTAT, 2021b.

12 INSTAT, 2021d.

13 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2021a.

14 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 2021a.

15 World Bank Group, 2021



18.8% e grave

në Shqipëri thonë që kanë mbetur jashtë fuqisë punëtore për shkak të përgjegjësive ndaj familjes



0.6% e burrave

në Shqipëri thonë që kanë mbetur jashtë fuqisë punëtore për shkak të përgjegjësive ndaj familjes



Biomasa

7% e furnizimit të energjisë gjithsej në Shqipëri

Burimi më i përdorur i energjisë në familje rurale

Burimi i tretë më i përdorur i energjisë në vend



41.4% e grave të punësuar

në Shqipëri punojnë në bujqësi



31.8% e burrave të punësuar

në Shqipëri punojnë në bujqësi

POR:



vetëm 7.8% e pronarëve të fermave janë gra

4.1.3. Dimensionet në lidhje me eficiencën e energjisë

Siç u trajtua edhe më lart, rolet tradicionale gjinore në nivel familjar përkeqësojnë vulnerabilitetin e grave në lidhje me ndryshimet klimatike, por edhe u japin atyre fuqi për të marrë disa vendime në familje, ndaj kur bëhet fjalë për eficiencën e energjisë, gratë kanë autonomi vendimmarrëse për blerjet shtëpiake, përfshi pajisjet e gatimit, ngrohjes dhe ftohjes. Ky konkluzion është nxjerrë nga vlerësimi kombëtar i potencialit të eficiencës së energjisë për reduktimin e emetimeve kombëtare të gazit serrë, i përfshirë në KKP-në e Shqipërisë 2021.¹⁶ Përveç kësaj, një nga udhëzimet më të fundit ndërkombëtare të UNDP-së¹⁷ sugjeron se gratë duhet të jenë objektivi i politikave dhe masave të eficiencës së energjisë si palët kryesore të interesit për zbatimin efektiv të tyre, por edhe për hartimin e tyre.

Gjetet e paragrafëve 1, 2 dhe 3 janë ilustruar në figura, si më poshtë:

¹⁶ Instituti i Kërkimeve Urbane, 2021.

¹⁷ UNDP, 2019.

Figura 1: Zinxhiri i ndikimit të ndryshimeve klimatike në vulnerabilitetin e grave, në familje





Figura 2: Zinxhiri i ndikimit të ndryshimeve klimatike në vulnerabilitetin e grave, sektori i bujqësisë



Ndikimi në Vulnerabilitetin e Grave




Figura 3: Zinxhiri i ndikimit të ndryshimeve klimatike në vulnerabilitetin e grave, sektori i energjisë







Figura 4: Dimensionet e vulnerabilitetit të grave ndaj ndryshimeve klimatike



Ndikimi në Vulnerabilitetin e Grave



4.2. Treguesit dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë

4.2.1. Burimi i të dhënave

Mbledhja e të dhënave gjinore rregullohet me ligj për qëllimet e mëposhtme:

- Monitorimi dhe vlerësimi i barazisë gjinore, dhe rekomandime për politika, sipas Udhëzimit nr. 1220, të datës 27 maj 2010, në mbështetje të ligjit nr. 9970 "Për barazinë gjinore në shoqëri";
- Planifikimi i buxhetit afat-mesëm, siç specifikohet në VKM nr. 465, të datës 18 korrik 2012 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm".

Për mbledhjen e të dhënave gjinore ligji përcakton përgjegjës INSTAT-in, ministritë e linjës dhe bashkitë.

Megjithatë, aktualisht nuk ka një databazë të dhënash kombëtare dhe bazë reference për treguesit e vulnerabilitetit të grave në lidhje me ndryshimet klimatike. Megjithëse nevoja për të identifikuar dimensionet e vulnerabilitetit të grave në nivel kombëtar është pranuar, vendi mbetet prapa sa i përket mbledhjes së të dhënave gjinore dhe klimatike. Mungesa ose aksesit i pamjaftueshëm i të dhënave limiton mundësitë e politikëbërësve për të identifikuar problematikat dhe palët kryesore të interesuara, për të zhvilluar politika të përshtatshme, gjithëpërfshirëse dhe të hartuara sipas nevojave të palëve të interesuara, dhe për të matur përfundimisht progresin në trajtimin e këtyre çështjeve. Pa të dhëna të besueshme dhe të ndara sipas gjinisë, është e vështirë jo vetëm të zhvillohen strategji klimatike efektive dhe me ndjeshmëri gjinore, por edhe të kuptohen plotësisht sfidat, ndikimi i gjerë i ndryshimeve klimatike dhe masa e ekspozimit ndaj kërcënimeve klimatike me të cilat përballen gratë.

Për këto arsye, është nevojë e menjëhershme të plotësohen boshllëqet e vazhdueshme në statistikat gjinore. Të dhënat e ndara sipas gjinisë për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave në punësim, arsim dhe proceset e vendimmarrjes mjedisore, bujqësore dhe energjetike, si dhe të dhënat specifike gjinore mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike, duhet të mblidhen vazhdimisht dhe të shpërndahen publikisht. Kjo kërkon rritjen e bashkëpunimit midis palëve të interesuara, veçanërisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të cilat duhet të forcojnë partneritetin dhe të koordinojnë përpjekjet mes tyre. Departamentet e statistikave të këtyre institucioneve dhe INSTAT-i duhet të synojnë bashkërisht të përmirësojnë përpjekjet e tyre për mbledhjen e të dhënave dhe ta bëjnë këtë informacion të disponueshëm jo vetëm për partnerët e tyre institucionalë, por edhe për publikun e gjerë.

Për më tepër, duhet të kryhen analiza të gjera socio-kulturore dhe politiko-ekonomike të kontekstit shqiptar për të marrë një kuptim të thellë të dinamikave të diferencuara gjinore në vend. Këto analiza jo vetëm që ndihmojnë në identifikimin e dimensioneve gjinore, por gjithashtu vendosin bazën për përcaktimin e kategorive dhe treguesve të të dhënave, si edhe për zhvillimin e bazave të referencës me të cilat matet efikasiteti dhe ndikimi i ndryshimeve të politikave. Për tu siguruar që këto dimensionet, kategori dhe tregues reflektojnë vërtet shqetësimet e grave, pjesëmarrja aktive e OSHC-ve të grave në proces duhet të promovohet dhe inkurajohet.

4.2.2. Burimet e treguesve

Treguesit në lidhje me ndryshimet klimatike, të ndarë sipas gjinisë mund të identifikohen nga burime të ndryshme:

Strategji kombëtare sektoriale: Aktualisht, siç u përshkrua edhe më lart, asnjë nga dokumentet strategjike kombëtare për ndryshimet klimatike ose për sektorë të lidhur me klimën, si bujqësia, energjia, eficientia e energjisë, energjia e rinovueshme dhe transporti, nuk integron mjaftueshëm elementet gjinore. Megjithatë, strategjia e re për bujqësinë (draft) propozon një listë të treguesve të ndarë sipas gjinisë, përkatësisht:

- numri i të punësuarve në bujqësi sipas gjinisë;
- numri i studentëve në zonat rurale/urbane sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë;
- pronësia e tokës sipas gjinisë dhe moshës;
- struktura e menaxherit të fermës sipas moshës dhe gjinisë;
- arsimimi/trajnimi i menaxherit të fermës sipas moshës dhe gjinisë.

Tregues shtesë për të cilët ndarja sipas gjinisë mund të jetë e dobishme, përfshijnë:

- treguesit e strategjisë për kategorinë "Struktura e fermave";
- treguesit e strategjisë për kategorinë "Të ardhurat nga ferma";
- treguesit e strategjisë për kategorinë "Menaxhimi i rrezikut";
- qasja në instrumentet e duhura financiare;
- qasja në teknologjitë e reja dhe/ose praktika të reja bujqësore.

Udhëzuesi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: bazuar në ligjin "Për ndryshimet klimatike", Neni 27(3), Ministria është përgjegjëse për përgatitjen e udhëzuesit për integrimin e gjinisë në politikat e zbatueshme dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ky udhëzues ofron dimensionet e ndryshimeve klimatike dhe treguesit e mundshëm që mund të ndahen sipas gjinisë.

Udhëzues të organizatave ndërkombëtare: Udhëzuesi i UNDP-së për integrimin e gjinisë në politikat e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike gjithashtu ofron disa dimensione dhe tregues të ndryshimeve klimatike që mund të ndahen sipas gjinisë¹⁸.

Studime kombëtare ose ndërkombëtare: studimet kombëtare ose ndërkombëtare mbi ndryshimet klimatike dhe sektorët e lidhur me të mund të paraqesin tregues të mundshëm që mund të ndahen sipas gjinisë.

4.2.3. Treguesit e eficiencës së energjisë

Vlerësimi kombëtar i potencialit të eficiencës së energjisë për të reduktuar emetimet kombëtare të gazit serrë, një projekt brenda fushëveprimit të KKP-së së Shqipërisë 2021¹⁹, ofron një databazë të treguesve të eficiencës së energjisë. Kjo bazë të dhënash përfshin tregues nga sektorët e transportit, bujqësisë dhe pylltarisë, sektorëve të banesave rezidenciale dhe industriale si dhe shërbime tregtare dhe publike. Ndarja gjinore është e rëndësishme për treguesit e identifikuar më poshtë:

Eficiencia e energjisë në sektorin e transportit:

- Totali i kilometrave të pasagjerëve të përshkuara me të gjitha mënyrat e transportit;
- Kilometrat e pasagjerëve të përshkuara me rrugë;
- Kilometrat e pasagjerëve të përshkuara me avion;
- Kilometrat e pasagjerëve të përshkuara me det;
- Kilometrat e pasagjerëve të përshkuara me hekurudhë;
- Shkalla e penetrimit të transportit kolektiv tokësor të pasagjerëve.

Ndarja sipas gjinisë nuk është e nevojshme për grupin e mëposhtëm të treguesve, por të dhënat janë të rëndësishme për hartimin dhe zbatimin efektiv të politikave dhe masave të eficiencës së energjisë ku gratë janë grup kryesor i interesit:

Eficiencia e energjisë në sektorin e ndërtimeve rezidenciale:

- Konsumi mesatar i ngrohjes, sipas burimit;
- Konsumi mesatar i energjisë për furnizimin me ujë të ngrohtë, sipas burimit;
- Shkalla e penetrimit të pajisjeve me eficiencë energjie, sipas llojit.

5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

5.1. Nga Ministria për Barazinë Gjinore

Monitorimi dhe vlerësimi i vulnerabilitetit të grave në lidhje me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar dhe vendor rregullohet në Udhëzimin nr. 1220 të datës 27 Maj 2010 "Për përcaktimin, mbledhjen dhe përpunimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të barazisë gjinore, dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje"; përrjedhojë, struktura për barazinë gjinore e Ministrisë për Barazi Gjinore monitoron dhe vlerëson treguesit e ndarë sipas gjinisë në lidhje me ndryshimet klimatike. INSTAT-i dhe ministritë e linjës prodhojnë dhe raportojnë rregullisht treguesit nëpërmjet formularëve 1 deri në 3, siç përshkruhet në nenet 3-8.

5.2. Nga Ministria për Mjedisin

Sipas ligjit nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike", përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e politikave kombëtare të ndryshimeve klimatike është Ministria për Mjedisin. Ky ligj kërkon ngritjen e një sistemi kombëtar të matjes, raportimit dhe verifikimit (MRV) për ndryshimet klimatike, në përputhje me UNFCCC-në dhe acquis e BE-së për ndryshimet klimatike. Neni 23 (1c, 1ç) i ligjit përcakton se INSTAT-i dhe ministritë e linjës, përfshi Ministrinë për Barazi Gjinore, duhet të mbledhin të dhënat gjinore dhe t'i ngarkojnë ato rregullisht në sistemin MRV. Nga ana tjetër, ligji "Për barazinë gjinore" kërkon që ministritë, përfshi Ministrinë për Mjedisin, të sigurojnë barazinë gjinore në fushat e kompetencës së tyre.

Sistemi MRV ende nuk është zhvilluar dhe zbatuar, por, siç përcaktohet me ligj, zbatimi i tij duhet të fillojë deri në vitin 2025. Më pas, Ministria për Mjedisin do të monitorojë dhe vlerësojë politikat kombëtare të ndryshimeve klimatike me ndjeshmëri gjinore dhe do të hartojë një raport për analizën e vulnerabilitetit të grave në Ministrinë për Barazi Gjinore, duke siguruar rishikime periodike të politikave kombëtare.

¹⁸ Ky studim i referohet vetëm udhëzimit të UNDP-së, por organe të tjera të OKB-së, ashtu si dhe Instituti European për Barazinë Gjinore kanë publikuar udhëzime që mund të merren në konsideratë.

¹⁹ Instituti i Kërkimeve Urbane, 2021.

6. PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE

Procesi i integritimit gjinor në politikën kombëtare të ndryshimeve klimatike përfshin hapat e mëposhtëm: (i) analiza e vulnerabilitetit të grave në lidhje me ndryshimet klimatike dhe (ii) hartimi i politikave kombëtare të klimës që integrojnë dimensionet rezultuese të vulnerabilitetit të grave. Ky proces mund të nisët nga Ministria për Mjedisin si dhe nga Ministria për Barazi Gjinore përmes Këshillit Kombëtar për Barazi Gjinore (KKBGJ), në të cilin të dy institucionet janë anëtarë.

Neni 12 (b), (ç) i ligjit "Për barazinë gjinore" thotë se përgjegjësia për integrimin gjinor në të gjitha fushat dhe për kryerjen e analizave të barazisë gjinore i takon KKBGJ-së, ndërsa neni 13(2a), 2b) përcakton se është përgjegjësi e Ministrisë për Barazi Gjinore të marrë masa për eliminimin e pabarazive gjinore dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Neni 7 (1), (4) përcakton se çdo institucion qeveritar është përgjegjës për garantimin e barazisë gjinore përmes masave legjislative dhe politike brenda fushës së kompetencës së tij. Institucioneve të pushtetit kombëtar dhe vendor u kërkohet të bashkëpunojnë me Ministrinë për Barazi Gjinore në përmbushjen e përgjegjësive të kësaj të fundit; kjo arrihet duke caktuar nëpunësit civilë, që janë përgjegjës për çështjet gjinore, në ministrinë e linjës dhe bashkitë, siç përcaktohet në nenin 13(3).

Pasi të fillojë procesi i integritimit gjinor, Ministria për Barazi Gjinore ngre një grup pune brenda strukturës së saj për barazinë gjinore, përkatësisht Drejtoria e Politikave për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, për të kryer një analizë të vulnerabilitetit të grave në lidhje me ndryshimet klimatike. Nëpunësit civilë që merren me çështjet gjinore në Ministrinë për Mjedisin dhe në ministrinë e linjës duhet të jenë pjesë e grupit të punës në procesin e analizës, së bashku me ekspertë të tjerë në fushat e kompetencës së ministrive të linjës. Për analizën duhet të konsultohen si Ministria për Mjedisin ashtu edhe KKBGJ, dhe ky i fundit miraton analizën.

Me miratimin e analizës, Ministria për Mjedisin harton strategjitë dhe dokumentet e politikave të integruara gjinore për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, ndër të cilat, më të rëndësishmet janë KKP-ja, Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës dhe Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike. Ministria për Mjedisin, aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mund të krijojë një grup pune për hartimin e këtyre dokumenteve - rekomandohet që grupi të krijohet brenda Grupit Ndërmintor të Punës për Ndryshimet Klimatike (GNPNK), pasi kjo strukturë institucionale është tashmë e vendosur. GNPNK

përgatit dhe miraton programin e punës të grupit të punës, i cili përfshin hartimin e politikave të integruara gjinore dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Gjatë gjithë procesit, Ministria e Mjedisit dhe GNPNK bashkëpunojnë me Ministrinë për Barazi Gjinore dhe ministrinë e tjera përkatëse të linjës.

Procesi institucional për integrimin gjinor në politikën e ndryshimeve klimatike është ilustruar në Figurën 5 më poshtë.


7. NEVOJAT PËR RREGULLIM LIGJOR

Për të siguruar integrimin efektiv të gjinisë në politikat kombëtare për ndryshimet klimatike, mund të nevojiten ndryshime të mëtejshme nënligjore për barazinë gjinore. Pas identifikimit të treguesve të ndarë sipas gjinisë për ndryshimet klimatike në analizën e parë kombëtare, të dhënat do të futen rregullisht në sistemin MRV të ndryshimeve klimatike të Ministrisë për Mjedisin, në përputhje me ligjin "Për ndryshimet klimatike" dhe aktet nënligjore të tij. Këto të dhëna duhet të krijohen rregullisht nga Ministria për Barazi Gjinore dhe INSTAT-i. Rrjedhimisht, rekomandohet që grupi i treguesve të ndarë sipas gjinisë për ndryshimet klimatike të organizohet në një formular dhe t'i shtohet listës së formularëve të parashikuar në Udhëzimin nr. 1220/2010 të ligjit "Për barazinë gjinore", duke specifikuar përgjegjësitë e INSTAT-it dhe/ose të ministrive të linjës, sipas fushës së tyre të kompetencës, për raportimin e rregullt të të dhënave duke u bazuar te ky formular. Për këtë qëllim, rekomandohet të bëhen ndryshime në këtë Udhëzim.

8. NEVOJAT PËR KAPACITETE

As analiza kombëtare e vulnerabilitetit të grave në lidhje me ndryshimet klimatike, as integrimi i dimensioneve të vulnerabilitetit të grave në politikën e ndryshimeve klimatike nuk është realizuar nga Qeveria e Shqipërisë. Dokumentet kombëtare të politikave për ndryshimet klimatike dhe raportet e barazisë gjinore deri më tani janë përgatitur nga palë të tjera të autorizuara, jo nga institucionet publike. Nëpunësit civilë të ngarkuar për çështjet gjinore në ministrinë e linjës kanë marrë trajnime të rregullta për çështjet gjinore, megjithatë, të dyja proceset kërkojnë ekspertizë të thelluar; prandaj, mund të jetë e nevojshme marrja e asistencës teknike dhe/ose shtimi i burimeve njerëzore. Gjithashtu, mbledhja e të dhënave të ndryshimeve klimatike të ndara sipas gjinisë për analizën e vulnerabilitetit të grave në lidhje me ndryshimet klimatike mund të kërkojë prezantimin e anketimeve të reja të rregullta, prandaj mund të nevojiten burime shtesë infrastrukturore dhe/ose burime njerëzore.

Figura 5: Procesi institucional për integrimin e gjinisë në politikat e ndryshimeve klimatike



Nëpërputhje me procesin institucional, rekomandohet që grupet e punës përgjegjëse për përgatitjen e dy dokumenteve, në bashkëpunim me INSTAT-in, të vlerësojnë burimet infrastrukturore dhe njerëzore të nevojshme për kryerjen e secilës prej analizave, përfshirë edhe krijimin e të dhënave.

Nevojat financiare

Nëpërmjet GNPNK-së, KKBGJ-ja dhe Ministria për Mjedisin kanë autoritetin ligjor për të marrë vendime mbi burimet financiare që nevojiten për përmbushjen e nevojave të kapaciteteve për integrimin efektiv gjinor në politikat e ndryshimeve klimatike, siç vlerësohet nga grupi i punës.

9. PËRFUNDIME E REKOMANDIME

9.1. Përfshirja e grave në konsultime dhe vendimmarrje

Megjithëse pjesëmarrja e grave në vendimmarrjen e lidhur me ndryshimet klimatike është shumë e nevojshme për integrimin e vulnerabilitetit të grave në politikat e ndryshimeve klimatike, gratë në përgjithësi janë të përjashtuara nga proceset e vendimmarrjes, si në kompani, ashtu edhe në organe qeveritare. Edhe në COP26 të Kombeve të Bashkuara, shumica e negociatorëve kryesorë ishin burra, ndërsa delegatet gra përbënin 33 për qind të të gjitha pozicioneve të panelit vendimmarrës dhe teknik në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike.²⁰ Në nivel kombëtar, burrat ende përbëjnë shumicën dërrmuese të posteve të politikëbërjes, ndërsa gratë mbanin vetëm 29.5 për qind të vendeve në parlament në vitin 2020.²¹ Ndërsa gratë vazhdojnë të jenë të anashkaluara në proceset kyçe të politikëbërjes lidhur me klimën në të gjitha nivelet, nevojat dhe sfidat e tyre specifike në lidhje me klimën rrezikojnë të mbeten të padëgjua dhe të patrajtuara.

Pavarësisht urgjencës, nevoja për të mundësuar dhe promovuar pjesëmarrjen e barabartë të grave në pozitat drejtuese në qeveri dhe institucionet e ndryshimeve klimatike mbetet e pa përmbushur. Nevojat dhe sfidat specifike të grave lidhur me klimën, dhe ato specifike gjinore, nuk mund të trajtohen me rigorozitet nëse gratë vazhdojnë të jenë të anashkaluara në proceset kyçe të hartimit të politikave klimatike në të gjitha nivelet. Për këtë arsye, promovimi i pjesëmarrjes aktive të grave është me rëndësi dhe urgjencë të madhe.

9.2. Bashkëpunimi ndër-institucional

Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë për Mjedisin dhe Ministrisë për Barazi Gjinore është thelbësor për të kryer me sukses analizën e vulnerabilitetit të grave si dhe për të integruar efektisht gjetjet e analizës në politikat kombëtare të ndryshimeve klimatike. Po me rëndësi është edhe rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet ministrive të linjës dhe Ministrisë për Mjedisin.

KKBGJ-ja mbështet komunikimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve dhe INSTAT-it. Gjithashtu, ky Këshill luan një rol kyç për avancimin e propozimeve mbi burimet financiare nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për mbështetjen e nevojave operationale dhe të kapaciteteve, dhe për mirëmbajtjen e të

dhënave të ndara sipas gjinisë. Grupi Ndërministror i Punës për Ndryshimet Klimatike mbështet dhe lehtëson komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet ministrive të linjës dhe INSTAT-it.

9.3. Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt

Së fundi, megjithëse gjatë viteve të fundit janë bërë përpjekje për të avancuar analizën gjinore dhe janë shtuar masat politike, monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave dhe masave të tilla në nivel kombëtar dhe vendor mungon ende në masë të madhe. Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimet e shpeshta janë kryesore për të garantuar efektivitetin e politikave dhe masave të ndërmarra. Për shkak të natyrës ndërsektoriale të barazisë gjinore dhe ndryshimeve klimatike, bashkëpunimi ndër-institucional është thelbësor.

20 United Nations Climate Change, 2021

21 INSTAT, 2021a

Referenca

Federation of Red Cross & Red Crescent Societies. 2015. Unseen, Unheard: Gender-Based Violence in Disasters [E paparë. E padëgjuar: Dhuna me bazë gjinore në katastrofa].

Instituti i Statistikave. 2021a. Përbërja e parlamentit që nga viti 1920.

Instituti i Statistikave. 2021b. Gratë dhe burrat në Shqipëri, 2021.

Instituti i Statistikave. 2021c. Depozitues dhe llogari depozituese sipas gjinisë në Bankat Tregtare.

Instituti i Statistikave. 2021d. Anëtarët e familjes të punësuar sipas kategorive të forcave të punës së familjes, klasave të sipërfaqes bujqësore të përdorur dhe gjinisë.

International Energy Agency. 2021. World Energy Outlook. [Perspektiva botërore e energjisë].

International Renewable Energy Agency. 2019. Renewable Energy: A Gender Perspective. [Energjia e rinovueshme: Një perspektivë gjinore].

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. 2021. Strategy for Agriculture, Rural Development and Fisheries 2021-2027. Working document. [Strategjia për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021-2027].

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2021a. Albania Revised NDC. Working document. [KKP-ja e rishikuar e Shqipërisë].

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2021b. First Biennial Update Report of Albania to the UNFCCC. [Raporti i parë i përditësuar dyvjeçar për UNFCCC-në].

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2019. Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planeve të Veprimit 2019-2030.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2016. Third National Communication of the Republic of Albania under the UNFCCC. [Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë nën UNFCCC-në].

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. 2021. Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore 2021-2030.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. 2019. National Review for Implementation of the Beijing Platform for Action. [Rishqyrtimi Kombëtar i Zbatimit të Platformës për Veprim të Pekinit].

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. 2021. National Energy and Climate Plan. Working document. [Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën].

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. 2018. National Energy Strategy. [Strategjia Kombëtare e Energjisë].

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. 2015. National Energy Efficiency Action Plan 2017-2020. [Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2020].

Neumayer, E. and Plümper, T. 2007. The Gendered Nature of Natural Disasters: The Impact of Catastrophic Events on the Gender Gap in Life Expectancy, 1981-2002. [Natyra gjinore e fatkeqësive natyrore: Ndikimi i katastrofave në hendekun gjinor të jetëgjatësisë, 1981-2002].

United Nations Development Program. 2019. Gender Responsive Indicators: Gender and NDC Planning for Implementations. [Treguesit me ndjeshmëri gjinore: Gjinia dhe planifikimi i KKP-ve për zbatim].

United Nations Climate Change. 2021. Overrepresentation of men in UN Climate Change Process Persists. [Mbipërfaqësimi i burrave në Procesin e Ndryshimeve Klimatike të OKB-së vazhdon].

UN Women. 2019. Progress of the World's Women 2019-2020. [Progresi i grave të botës 2019-2020].

United Nations Industrial Development Organization & UN Women. 2013. Sustainable energy for all: The gender dimensions. [Energji e qendrueshme për të gjithë: Dimensionin gjinor].

Instituti i Kërkimeve Urbane. 2021. Additional potential of energy efficiency for the enhancement of Albania's NDC 2030. [Potenciali shtesë i eficiencës së energjisë për përmirësimin e KKP-së së Shqipërisë 2030].

World Bank Group. 2021. Climate Risk Profile: Albania. [Profili i rrezikut klimatik: Shqipëria].



GREEN
CLIMATE
FUND



INSTITUTI
I KËRKIMEVE
URBANE



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT

